

Tiranë, më 20.07.2026

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - MALL

PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

Objekti i prokurimit: “Blerje kasa automatike për sistemet e parkimit”

Kodi përkatës në fjalorin e përbashkët të prokurimit (CPV): Pajisje elektronike – 31710000
6; Pajisje për kontrollë në parkime - 34926000-4.

Vlera e fondit limit të marrëveshjes kuadër/ vlera e pritshme e kontratave : 45,420,000
(dyzetë e pesë milion e katërqind e njëzet mijë) lekë pa TVSH ose **484,893** (katerqind e tetëdhjetë e kater mijë e teteqind e nentëdhjetë e tre) euro pa TVSH.

** Kursi zyrtar i këmbimit sipas Bankës së Shqipërisë në datën 20/07/2026 është 93,67 Lekë/Euro.*

Kohëzgjatja e kontratës/marrëveshjes kuadër ose afati për zbatimin e saj: 3 (tre) muaj nga data e nënshkrimit të kontratës.

Në bazë të Nenit 21, pika 2, të Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar); Nenit 2, pika 2/c si dhe Nenit 78, pika 2, të VKM Nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (i ndryshuar), Autoriteti Kontraktor, Tirana Parking, ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

Argumentimi në lidhje me Nenin 39, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, për mos ndarjen në lote të procedurës së prokurimit:

Arsyeja kryesore e mosndarjes së procedurës së prokurimit në lote është se referuar preventivit të procedurës, specifikimeve teknike, Autoriteti Kontraktor e ka të pamundur teknikisht ta ndajë këtë kontratë në lote të veçantë, pasi do e bënte shumë të vështirë për t’u menaxhuar.

Kjo procedurë malli duhet të kryhet nga një operator ekonomik i cili do të shpallet fitues, pasi furnizimi i artikujve nga një operator ekonomik e bën më efektiv organizmin e punës por sidomos e bën shumë më të përshtatshëm monitorimin dhe raportimin e të gjitha proceseve të punës. Ndarja në lote nuk është e përshtatshme për arsye teknike, funksionale dhe ekonomike, pasi do të sillte konfuzion dhe ndarja në lote do të sillte çrregullim në proces dhe vështirësi në monitorim të

furnizimit me kasat automatike dhe garantimin e vazhdueshmërisë së ofrimit të shërbimit të parkimit.

Nga ana tjetër referuar Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, neni 2 prashikohet shprehimisht se: *“Qëllimi i këtij ligji është:*

- a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik;*
- b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale;*
- c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik;*
- ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë;*
- d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik;*
- dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.*

Në kreun V, Neni 42, pikat 1 dhe 2 të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” (i ndryshuar), parashikohet shprehimisht:

“1. Autoriteti/enti kontraktor e ndan një kontratë në lote sa herë kjo është e mundur. Në çdo rast, duhet të përcaktohet qartë madhësia dhe objekti i këtyre loteve.

2. Autoriteti kontraktor, në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar, në rast se vendos të zhvillojë procedurën e prokurimit pa e ndarë në lote, duhet të parashikojë një përcaktim të arsyeve kryesore për këtë vendim, i cili bëhet pjesë e dosjes së tenderit. Ky detyrim nuk zbatohet në rastin e kontratave sektoriale”.

Referuar Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” (i ndryshuar), neni 14, Operatorët ekonomikë, prashikohet shprehimisht se:

“1. Kandidatët ose ofertuesit mund të jenë persona fizikë ose juridikë.

2. Grupe operatorësh ekonomikë mund të dorëzojnë oferta ose të paraqiten si një kandidat i vetëm sipas parashikimeve në rregullat e prokurimit publik. Autoriteti ose enti kontraktor nuk duhet t’i kërkojë një formë të veçantë ligjore bashkimit të shoqërive, për qëllim të dorëzimit të ofertës ose kërkesës për pjesëmarrje.

Autoritetet ose entet kontraktore mund t’u kërkojnë grupeve të operatorëve ekonomikë që të marrin një formë ligjore specifike, pasi të jenë shpallur fitues, nëse vlerësohet e nevojshme për realizimin e kontratës. Në çdo rast, ky kusht duhet t’u bëhet i ditur operatorëve ekonomikë në dokumentet e tenderit për ekzekutimin e kënaqshëm të kontratës.

3. Rregullat për mënyrën e plotësimit të kritereve nga grupet e operatorëve ekonomikë në një procedurë prokurimi përcaktohen në rregullat e prokurimit publik”.

Në VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” (i ndryshuar), Kreu XI, neni 88, është parashikuar:

1. Oferta mund të paraqitet nga një bashkim operatorësh ekonomikë, sipas përcaktimit të pikave 2 dhe 3, të nenit 14, të LPP-së, ku njëri prej të cilëve i përfaqëson të tjerët gjatë procedurës dhe, në rast përzgjedhjeje, edhe gjatë zbatimit të kontratës. Në ofertë duhet të përcaktohet pjesa e shërbimit, punës ose furnizimit, që do të kryejë secili nga anëtarët e këtij bashkimi nëpërmjet një kontrate bashkëpunimi të hartuar ndërmjet palëve.

2. Anëtarët e bashkimit të operatorëve ekonomikë caktojnë në kontratën e bashkëpunimit ndërmjet tyre, përfaqësuesin e tyre për dorëzimin e ofertës. Kjo kontratë bashkëpunimi duhet të dërgohet së bashku me kualifikimet dhe ofertën ekonomike, e cila duhet të nënshkruhet nga përfaqësuesi. Përfaqësuesi duhet të bëjë edhe sigurimin e ofertës, duke specifikuar pjesëmarrjen në bashkimin e operatorëve ekonomikë.

3. Secili prej anëtarëve të këtij bashkimi duhet të përmbushë kërkesat e parashikuara në nenin 76, të LPP-së, dhe ato të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Kërkesat për kualifikim: ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike, duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen dhe/ose natyrën e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në aktmarrëveshje.

Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, kushti i përcaktuar në shkronjën “a”, të pikës 5, të nenit 39, të këtyre rregullave, plotësohet nga anëtari, i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontrata të ngjashme, në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. Në rastin kur operatorët ekonomikë, anëtarë të një bashkimi, kanë të njëjtën përqindje pjesëmarrjeje në bashkim, vendosin me marrëveshje në kontratën e bashkëpunimit se cila prej tyre do të përmbushë këtë kusht.

Referuar sa më sipër legjislacioni i prokurimit publik njeh gjithashtu të drejtën e shoqërive për t'u bashkuar, për të përmbushur një kontratë prokurimi, në kushtet kur kjo kontratë nuk mund të realizohet nga një operator ekonomik.

Objekti i kontratës përbën një sistem të integruar, ku të gjithë komponentët duhet të jenë plotësisht të përputhshëm dhe të funksionojnë si një i vetëm. Kasat automatike duhet të komunikojnë dhe të integrohen me sistemin ekzistues ose me komponentët e tjerë të sistemit të parkimit, duke garantuar funksionim të pandërprerë, shkëmbim të dhënash në kohë reale dhe administrim të unifikuar.

Ndarja në lote mund të sjellë furnizim nga operatorë ekonomikë të ndryshëm, duke rritur rrezikun e mospërputhjes teknike ndërmjet pajisjeve dhe softuerëve, vështirësi në integrim, vonesa në vënien në funksion të sistemit, si dhe paqartësi në përcaktimin e përgjegjësi për mirëmbajtjen, garancinë dhe zgjidhjen e defekteve.

Gjithashtu, zhvillimi i procedurës si një kontratë e vetme mundëson një koordinim më të mirë të furnizimit, instalimit, konfigurimit, testimit dhe trajnimit të personelit, duke siguruar përgjegjësi të unifikuar nga kontraktori dhe ulje të kostove administrative për menaxhimin dhe monitorimin e kontratës.

Akoma më tej, legjislacioni me ndryshimet e fundit që ka pësuar ka hequr nevojën për kontratë noteriale por vetëm paraqitjen e një kontratë bashkëpunimi ndërmjet operatorëve ekonomik, të cilët ushtrojnë aktivitetin e tyre në qarqe të ndryshme.

Në varësi të zërave që do të marrin përsipër të mbulojnë apo bashkimin e fuqisë punëtore dhe stafit, përcaktohet përqindja e pjesëmarrjes dhe elementët koktrete që do të kryejë secili nga anëtarët e këtij bashkimi. Secili prej anëtarëve të këtij bashkimi duhet të përmbushë kërkesat e parashikuara në nenin 76, të LPP-së, dhe ato të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Kërkesat për kualifikim: ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike, duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen dhe/ose natyrën e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në aktmarrëveshje

Për sa më sipër, Autoriteti Kontraktor vlerëson se mosndarja e procedurës në lote është e justifikuar, pasi garanton realizimin efektiv të objektit të kontratës, funksionalitetin e sistemit, përputhshmërinë teknike të të gjithë komponentëve dhe administrimin më efikas të kontratës.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar, Autoriteti Kontraktor, Tirana Parking ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim me përmbajtjen si më poshtë, për procedurën me objekt “Blerje kasa automatike për sistemet e parkimit”.

KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT:

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 4;

b. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 9;

Argumentimi: Kriteret e mësipërme janë vendosur në përputhje me Nenin 82 “Formulari përmbledhës i vetdeklarimit” dhe Neni 83 “Sigurimi i ofertës”, të Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar), si dhe në mbështetje të nenit 30, pika 1, të VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” (i ndryshuar), citojmë Nenin 83 të LPP-së: “Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël”, Neni 82, i LPP “1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoritetet ose entet kontraktore pranojnë si provë paraprake në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas parashikimeve të këtij ligji. Përmbajtja e këtij formulari përcaktohet në rregullat e prokurimit publik”.

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):

2.1.1 Referuar pikës 1 të shtojcës 8, ofertuesi duhet të deklarojë se përmbush kriteret e përgjithshme të pranimit/kualifikimit. Këto kriteret duhet të plotësohen me dorëzimin e vetëdeklaratës me shkrim të subjektit, në ditën e hapjes së ofertave, sipas Shtojcës 9.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenit 40, pika 7, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" (i ndryshuar), si dhe shtojcës 9 të DST-së.

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet e fundit financiare 2023, 2024 dhe 2025, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar, duhet të jetë **jo më e vogël se vlera e përlogaritur e kontratës/ vlera e pritshme e kontratës që prokurohet**, lëshuar nga autoriteti përkatës. Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit/ vlera e pritshme e kontratës së përlogaritur, si dhe nenin 77, pika 3, të LPP, si dhe nenin 43, pika 2/a, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë: "Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë:

Pika 2/a: dyfishin e vlerës së përlogaritur të kontratës ose lotit, në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar;". Vlera e përlogaritur është mbi kufirin e lartë monetar dhe për këtë arsye, vlera e xhiros minimale të kërkuar, është brenda kufirit të parashikuar në dispozitat ligjore të sipërcituara.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" (i ndryshuar), si dhe në legjislacionin e fushës në fuqi, përkatësisht në Ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, VKM nr. 922 datë 29.12.2014 "Për deklarimin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formës elektronike", si dhe në Udhëzimin e Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar.

Vendosja e këtij kriteri kualifikues i shërben Autoritetit Kontraktor për të vërtetuar se operatori ekonomik i zoteron historik mbi kapacitetet ekonomike dhe financiare për të përmbushur me sukses kontratën. Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar se, ky kriter kualifikues i shërben Autoritetit Kontraktor për t'u njohur me gjendjen ekonomike të operatorit ekonomik të paktën për tre vitet e fundit dhe për të patur siguri që operatori ekonomik fitues i zotëron të gjitha kapacitetet ekonomike dhe financiare për të përmbushur me sukses kontratën.

2.2.2 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin kopje të bilanceve të **3 (tre) viteve të fundit** financiare (2023,2024,2025) të paraqitura pranë autoriteteve përkatëse tatimore që tregojnë raporte ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit. Në rast se operatori ekonomik është në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, të ligjit nr.10091, datë 05.03.2009, atëherë bilancet duhet të shoqërohen edhe me raportet e auditimit ligjor të pasqyrave financiare vjetore, të kryera, nga auditues ligjorë ose shoqëri

audituese. (Kriteri konsiderohet i përmbushur nëse në dy bilancet e njëpasnjëshme të kërkuara nuk ka raport negative ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit).

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, është bërë bazuar në nenin 29, pika 1 të Ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat” i ndryshuar si dhe kërkesave të Ligjit nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”.

Akt Ekspertiza e Ekspertit Kontabël të Autorizuar, duhet të paraqitet nga O.E vetëm në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, gërma “c” të Ligjit nr. 10091, datë 05.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar”, i ndryshuar, ku parashikohet se: “Personat juridikë që detyrohen për auditimin ligjor të pasqyrave financiare detyrohen të kryejnë auditimin ligjor të pasqyrave financiare vjetore, përpara publikimit të tyre, nga ekspertë kontabël ose shoqëri audituese: "c) shoqëritë me përgjegjësi të kufizuar, të cilat zbatojnë për raportimin financiar standardet kombëtare të kontabilitetit, kur, në mbyllje të periudhës kontabël, **për dy vite radhazi, tejkalojnë dy prej tre treguesve të mëposhtëm:** i) totali i aktiveve të bilancit, në mbyllje të periudhës kontabël përkatëse, arrin ose e kalon shumën prej 50 milionë lekësh; ii) shuma e të ardhurave nga veprimtaria ekonomike (qarkullimi) në atë periudhë kontabël arrin ose e kalon shumën prej 100 milionë lekësh; iii) ka, mesatarisht, 30 të punësuar gjatë periudhës kontabël.

2.2.3 Vërtetim për shlyerjen e taksave vendore të parashikuara nga Pushteti Vendor për vitin 2025 dhe këstin përkatës për vitin 2026 sipas përcaktimeve të Ligjit Nr.9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, (i ndryshuar). Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vërtetimin lëshuar nga Autoriteti përkatës sipas adresave të regjistruar sipas QKB. (Kjo kërkesë do të konsiderohet e përmbushur gjatë fazës së ofertimit me plotesimin e formularit të vetedeklarimit, dokumentet përkatëse vërtetuese do të paraqiten nga operatori ekonomik i klasifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit).

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar në nenin 77, pika 3, e LPP, nenin 43, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (i ndryshuar), si dhe ligjin nr.9920 datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore” i ndryshuar, neni 4, pika 2, gërma d) dhe në ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar.

Ky kriter shërben për të garantuar AK se, operatorët ekonomikë pjesëmarrës në këtë procedurë prokurimi, kanë kapacitetet e duhura ekonomike dhe financiare, si dhe janë të përshtatshëm për të kryer veprimtari profesionale. Referuar sa më sipër, Autoriteti Kontraktor gjykon se kriteri i vendosur lidhur me dorëzimin nga ana e operatorëve ekonomikë të deklaratës për shlyerjen e detyrimeve vendore për vitin 2025 pranë bashkisë/ve ku operatori ekonomik ushtron aktivitetin e tij është në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi e konkretisht me ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 për “Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar. Të gjithë subjektet që ushtrojnë veprimtari biznesi kanë detyrimin ligjor të regjistrimit pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit për të bërë të

identifikueshëm vendodhjen e aktivitetit të tyre dhe për t'iu nënshtuar pagesës së taksave vendore të parashikuara shprehimisht në këtë ligj.

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme të kryera gjatë **3 (tre) viteve të fundit** nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, **në vlerën jo më pak se 40% e vlerës së fondit limit të lotit**. Këto furnizime të mëparshme, të ngjashme, duhet të vërtetohen me dokumentacionin si më poshtë:

a. Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me ente publike, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetimin e lëshuar nga enti publik për përmbushjen me sukses të kontratës dhe/ose faturat tatimore të shitjes të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

b. Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me subjekte private, operatori ekonomik duhet të paraqesë faturën përkatëse tatimore të shitjes të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

- Për kontratat e realizuara si Bashkim Operatorësh, operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë: kontratën e bashkimit të operatorëve dhe prokurën e posaçme, të deklaruara në fazën e tenderimit.
- Për kontratat e realizuara si nënkontraktor, operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë: kontratën bazë ndërmjet kontraktorit dhe autoritetit kontraktor, kontratën e nënkontraktimit dhe aktin e miratimit zyrtar si nënkontraktor.

Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”(i ndryshuar) dhe nenit 41, pika 3 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”(i ndryshuar). Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që shërbimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 40 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme është vendosur brenda kufirit të vlerës të përcaktuar në rregullat e prokurimit publik dhe i shërben AK për të treguar se ofertuesit me kapacitetet e tyre kanë realizuar kontrata të ngjashme me objektin që prokurohet, në vlerë jo më të vogël se 40 % të fondit limit, në afat, me cilësi dhe rrit besueshmërinë mbi përvojën që ka ofertuesi në treg. Përvoja e ngjashme konsiderohet si kriter thelbësor dhe si rrjedhim, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmi të tilla si: referenca/fatura tatimore, për të provuar kryerjen e tyre qoftë me sektorin privat dhe atë publik. Për shkak të rëndësisë që ka vetë Institucioni dhe llojit të mallit/shërbimit objekt prokurimi, i rëndësishëm për ushtrimin e funksioneve të ofrimit të shërbimit, me qëllim krijimin e marrëdhënieve kontraktuale me operatorë ekonomikë seriozë në treg, me performancë të mirë e të vazhdueshme është kërkuar marzhin e vlerës së parashikuar

sipas Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe VKM nr.285, datë 19.05.2021 (i ndryshuar).

2.3.2 Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë certifikatat ose ekuivalente të tyre të lëshuara nga organizmat e vlerësimit të konformitetit, të akredituara nga organizmi kombëtar i akreditimit DPA, ose organizma ndërkombëtare akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, të jenë të vlefshme, e që kanë lidhje me objektin e kontratës, si më poshtë:

a) Standardin ISO 9001:2015 ose ekuivalent (e përditësuar), për sistemin e menaxhimit të cilësisë, objekt i të cilës të jetë në përputhje me objektin e prokurimit (e vlefshme) dhe të lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

b) Standardin ISO 27001:2022 ose ekuivalent (e përditësuar), për sistemin e menaxhimit të sigurisë së informacionit, objekt i së cilës të jetë në përputhje me objektin e prokurimit (e vlefshme) dhe të lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

***Në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Certifikatat ISO sipas zërave të mallrave që do të marrë përsipër të realizojë sipas akt marrëveshjes.*

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme janë përcaktuar në mbështetje të nenit 77, pika 4 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar,

...“Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie...”, si dhe në mbështetje të nenit 44, pika 1, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” (i ndryshuar) konkretisht:

... “Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit...”.

ISO 9001:2015 (ose e përditësuar) parashikon një tërësi rregullash që garantojnë një bazë rreziku parandalues ndaj cilësisë e cila mbulon një gamë të gjerë të çështjeve ku përfshihen: angazhimi i lartë i menaxhimit për cilësi nga furnizuesi, fokusin e klientit, përshtatshmërinë e burimeve të tij, kompetencën/profesionalizmin e punonjësve, procesin e menaxhimit (për prodhim, ofrimin të shërbimeve dhe proceset mbështetëse e administrative), planifikimin e cilësisë, dhe një kërkesë për të nxitur përmirësimin. Kjo kërkesë, dëshmon se mbajtësi i saj garanton standardet ndërkombëtare të menaxhimit të cilësisë së ushtrimit të aktivitetit tregtar të tij. Nisur nga rëndësia, volumi i kontratës në këtë procedurë është e rëndësishme me qellim realizimin me sukses të kësaj procedurë që operatori pjesëmarrës të provojnë se ka një sistem të menaxhimit të cilësisë, pra të demonstrojnë aftësinë e tij për të ofruar vazhdimisht produkte që plotësojnë kërkesat e

konsumatorëve, pra të AK-së dhe kërkesat e zbatueshme ligjore dhe rregullative me qëllim të rrisë kënaqësinë e konsumatorit nëpërmjet zbatimit efektiv të sistemit, duke përfshirë proceset për përmirësimin e vazhdueshëm të sistemit dhe sigurimin e konformitetit ndaj klientit pra AK-së .

Sistemi i menaxhimit të shërbimit është një kuadër standardizues në lidhje me garancitë që kërkon autoriteti kontraktor nga operatorët ekonomike për: ndjekjen konsistente përgjatë afatit të zbatimit të kontratës, sipas kërkesave të DST-së.

ISO 27001:2022 (ose e përditësuar) siguron që operatori ekonomik ka të implementuar një sistem ofrimi të shërbimit përmes të cilit efektivisht planifikon, implementon, operon, monitoron, kontrollon dhe mirëmban portofolin e shërbimeve dhe cilësinë e tyre. Kërkesat përfshijnë projektimin, ofrimin dhe përmirësimin e shërbimeve për të përmbushur kërkesat e dakorduara të shërbimit, nëpërmjet sigurisë së nevojshme për ecurinë e punës së AK. Është një kuadër standartizues në lidhje me garancitë që kërkon Autoriteti Kontraktor nga operatorët ekonomikë në lidhje me respektimin e kërkesave rregullatore në lidhje me sigurinë e informacionit, gjë që mund të zvogëlojë rrezikun e veprimeve jo ligjore.

Në kushtet që instalimi dhe realizimi i konfigurimeve të nevojshme të sistemit, kërkon ndërhyrje në infrastrukturën ekzistuese të Institucionit, si rrjedhojë certifikimi ISO 27001, është një garanci e nevojshme për Autoritetin Kontraktor për aplikimin e praktikave mbi menaxhimin e risqeve, trajtimin e të dhënave dhe shërbimeve që do të kryhen. Të gjitha të dhënat që do të trajtohen dhe do të ruhen në sistem, përfshirë edhe ato të konfigurimit si dhe të përdoruesve të sistemit janë të ndjeshme. Aksesit në infrastrukturën ekzistuese të Institucionit dhe aksesit në informacion për të realizuar shërbimet sa më sipër do të jetë i kontrolluar e monitoruar nga stafi monitorues i kontratës, megjithatë certifikimi ISO 27001 për operatorin ekonomik është një garanci e nevojshme për Autoritetin Kontraktor.

2.3.3 Operatori ekonomik duhet të ketë në stafin e tij, jo më pak se 6 (gjashtë) punonjës për 3 muajt e fundit. Për këtë operatorët ekonomik ofertues duhet të paraqesin vërtetim nga Drejtoria e Tatimeve për numrin e punonjësve të siguruar për periudhën jo më pak se 3 (tre) muajt e fundit, shoqëruar me listë pagesat e sigurimeve shoqërore (formularët E-sig 025 a) për këtë periudhë, të konfirmuara nga organet tatimore.

Shënim: Ky kriter do të përmbushet nga OE me anë të Formularit Përmbledhës së Vetëdeklarimit sipas Shtojcës 9. Operatori ekonomik i kualifikuar i pari në klasifikim duhet të dorëzojë pranë AK, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, të gjithë dokumentacionin provues për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit. Autoriteti Kontraktor rezervon të drejtën të kryejë të gjithë verifikimet e nevojshme për të vërtetuar deklarin e mësipërm.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” (i ndryshuar), konkretisht: “Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën

sipas një standardi të përshtatshëm cilësie...]” dhe nenit 40, pika 5, paragrafi c) të VKM Nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” (i ndryshuar), ku citohet se: “Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon: c) fuqinë punëtore të operatorit ekonomik të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit; dhe/ose”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që, operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e tyre, të nevojshëm, për realizimin me sukses të objektit të prokurimit dhe/ose komponentët e tij.

Konkretisht: Nisur nga vlera relativisht e lartë e fondit limit, rëndësia për realizimin e kontratës, në kohë është gjykuar e nevojshme nga AK, që të sigurohet për qëndrueshmërinë në numrin e punonjësve të operatorit ekonomik konkurrues, të vërtetojë ky i fundit ekspertizën e tij profesionale duke paraqitur të paktën listëpagesat e personelit të kërkuar më lart për 3 muajt e fundit, si dhe numrin e punonjësve që të jetë të paktën 6 (gjashtë) vetë, ku kjo organikë personeli do ishte minimalja e mundshme për të përballuar realizimin e kësaj kontrate.

Ndaj është parë e arsyeshme që ofertuesit të mund të ofrojnë siguri se do të jenë në gjendje të përmbushin në kohën e nevojshme, kërkesat e paraqitura nga autoriteti.

Kërkesa e AK për paraqitjen e listëpagesave sipas Formularit E-sig 025/a për 3 (tre) muajt e fundit të deklaruar sipas legjislacionit në fuqi, paraqitjes së formularit përmbledhës të vetëdeklarimit sipas shtojcës 9, pjesa III, pika B, shërben në vetvete si garanci paraprake për realizimin dhe zbatimin e kontratës përgjatë periudhës së sipërcituar, duke qenë se nuk ka një mënyrë tjetër për të vërtetuar disponibilitetin e stafit në momentin e zhvillimit të procedurës së prokurimit dhe gjatë kohës së zbatimit të saj.

2.3.4 Operatori ekonomik duhet të ketë të punësuar të paktën 1 (një) ose më shumë punonjës të specializuar/të kualifikuar, një dokument që vërteton kualifikimin profesional (dëshmi kualifikimi/ profesional/ certifikatë/ diplomë) dhe të figurojë në listëpagesat e shoqërisë për 3 muajt e fundit të deklaruar nga data e hapjes së ofertave, si më poshtë:

- 1 (një) specialist i certifikuar për sistemet e parkimit “CAME PARKARE” (ose ekuivalent)
- 1 (një) specialist i certifikuar për sistemet e kasave automatike,
- 1 (një) specialist i certifikuar për instalime elektrike,

Për të dëshmuar përmbushjen e kriterëve sa më sipër, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin:

- Çertifikatat /Transkriptet përkatese të vlefshme të lëshuar nga subjekte të licensuar për ofrimin e kurseve për formim profesional sipas legjislacionit në fuqi në Republikën e Shqipërisë ose nga vëndi i origjinës së mallit objekt prokurimi, për secilin specialist/ekspert të kualifikuar.
- CV e punonjësit.
- Listëpagesa sipas formularit eSig25, për 3 (tre) muajt e fundit të deklaruar sipas legjislacionit në fuqi ku të përfshihet stafi si më sipër, nëpërmjet paraqitjes së formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9, pjesa III, pika B.

Në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, Deklarata B, operatorët ekonomik pjesëmarrës si dhe subjektet mbështetës të deklaruar nga operatorët pjesëmarrës si subjekt mbështetës, duhet të deklarojnë për stafin e kërkuar më sipër, të dhënat si më poshtë:

- emër/mbiemër, numër dhe date kontrate individuale të punës, certifikatë/diploma përkatëse, si dhe institucioni që ka lëshuar dokumentin.

Shënim: Ky kriter do të përmbushet nga OE me anë të Formularit Përmbledhës së Vetëdeklarimit sipas Shtojcës 9. Operatori ekonomik i kualifikuar i pari në klasifikim duhet të dorëzojë pranë AK, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, të gjithë dokumentacionin provues për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit. Autoriteti Kontraktor rezervon të drejtën të kryejë të gjithë verifikimet e nevojshme për të vërtetuar deklarin e mësipërm.

Argumentimi: Ky kriter është vendosur në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” (i ndryshuar) dhe nenit 41, pika 4) b) dhe c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” (i ndryshuar), me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë fuqinë punëtore të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën. Konkretisht:

Neni 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, pika 4:

[...Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie...] VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (i ndryshuar), Neni 41, pika 4) b).

“Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon: b)një listë të personelit kryesor, të nevojshëm për të zbatuar objektin e prokurimit dhe/ose komponentët e saj. Lista e personelit kryesor duhet të përfshijë CV-të e tyre dhe licencat profesionale, kur kanë të tilla sipas legjislacionit përkatës; dhe/ose..”

Kriteret për kualifikim vendosen që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale etj., reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

Kërkesa për staf është e nevojshme për të garantuar Autoritetin Kontraktor se OE disponon kapacitetet me qëllim përmbushjen e objektivave të kontratës, qëllimit dhe rezultateve që pritet të arrihen.

Kërkesa për 1 (një) specialist të certifikuar për sistemet e parkimit "CAME PARKARE" (ose ekuivalent) është vendosur për të garantuar instalimin, konfigurimin, integrimin dhe vënien në funksion të sistemit të parkimit në përputhje me kërkesat teknike të prodhuesit. Ky specialist siguron kompatibilitetin e komponentëve dhe funksionimin e saktë të sistemit.

Kërkesa për 1 (një) specialist të certifikuar për sistemet e kasave automatike është e nevojshme për instalimin, programimin, konfigurimin dhe testimin e kasave automatike, si dhe për integrimin

e tyre me sistemin e menaxhimit të parkimit, duke garantuar funksionim të sigurt dhe të qëndrueshëm.

Kërkesa për 1 (një) specialist të certifikuar për instalime elektrike është vendosur për të garantuar realizimin e lidhjeve elektrike sipas standardeve teknike dhe rregullave të sigurisë, duke siguruar furnizimin korrekt me energji të pajisjeve dhe funksionimin e tyre pa rrezik.

2.3.5 Operatori ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë se merr përsipër me anë të mjeteve të tij të bëjë furnizimin e mallit objekt prokurimi instalimin dhe vendosjen e tyre, në sheshparkimet e përcaktuara nga autoriteti kontraktor.

Argumentimi: Ky kriter është vendosur në përputhje me pikën 4, të nenit 77 të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe pikën 8, të nenit 40, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Kërkesa që operatori ekonomik të paraqesë një deklaratë me anë të së cilës merr përsipër të kryejë me mjetet e tij furnizimin, transportin, instalimin dhe vendosjen e pajisjeve në sheshparkimet e përcaktuara nga Autoriteti Kontraktor është vendosur duke marrë në konsideratë natyrën dhe kompleksitetin e objektit të prokurimit.

Kasat automatike të sistemit të parkimit janë pjesë e një sistemi të integruar që kërkon transport të specializuar, pozicionim të saktë, montim, lidhje elektrike, konfigurim, testim dhe integrim me komponentët e tjerë të sistemit të parkimit. Çdo fazë e procesit duhet të realizohet nga operatori ekonomik në mënyrë profesionale, në përputhje me kërkesat teknike të prodhuesit dhe specifikimet e Autoritetit Kontraktor, me qëllim garantimin e funksionimit korrekt dhe të pandërprerë të sistemit.

Përmes kësaj deklarate, Autoriteti Kontraktor sigurohet që operatori ekonomik merr përgjegjësinë e plotë për realizimin e të gjitha fazave të kontratës, nga furnizimi deri në instalimin dhe vënien në funksion të pajisjeve në sheshparkimet e përcaktuara. Kjo shmang problematikat që mund të lindin nga angazhimi i palëve të treta, garanton një përgjegjësi të unifikuar gjatë ekzekutimit të kontratës, si dhe siguron respektimin e afateve, cilësisë së punimeve dhe funksionalitetit të plotë të sistemit të parkimit.

2.3.6 Operatori ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë, me anë të së cilës merr përsipër garancinë për mallrat objekt prokurimi për një periudhë jo më pak se **2 (dy) vjet** nga data e marrjes në dorëzim nga Autoriteti Kontraktor. Mallrat që do të dorëzohen pranë AK duhet të kenë dhe garancinë e mallit të lëshuar nga prodhuesi. Gjatë periudhës së garancisë, operatori ekonomik merr përsipër të riparojë ose zëvendësojë, pa kosto shtesë për AK, çdo mall që paraqet defekte ose mosfunksionim, si pasojë e defekteve të prodhimit, materiale ose montimit.

Argumentimi: Ky kriter është vendosur në përputhje me pikën 4, të nenit 77 të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe pikën 8, të nenit 40, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Kërkesa për paraqitjen e një deklarate për garantimin e mallrave për një periudhë minimale prej 2 (dy) vjetësh është vendosur duke marrë në konsideratë natyrën e objektit të prokurimit, i cili përfshin furnizimin dhe instalimin e kasave automatike për sistemet e parkimit. Këto pajisje janë sisteme elektronike dhe elektromekanike që

do të jenë në funksionim të vazhdueshëm dhe ekspozohen ndaj përdorimit intensiv dhe kushteve të ndryshme mjedisore.

Periudha e garancisë është e nevojshme për të siguruar që çdo defekt i mundshëm i prodhimit, materialeve ose funksionimit të korrigjohet nga operatori ekonomik pa kosto shtesë për Autoritetin Kontraktor, duke garantuar vazhdimësinë e shërbimit, funksionimin normal të sistemit të parkimit dhe mbrojtjen e investimit publik.

Ky kriter është në përpjesëtim me objektin e kontratës, nuk kufizon konkurrencën dhe synon të garantojë furnizimin me pajisje cilësore, si dhe përgjegjësinë e operatorit ekonomik për funksionimin e tyre gjatë periudhës së garancisë.

2.3.7 Operatori Ekonomik Ofertues duhet të paraqesë një deklaratë se software-i i kasave automatike të ofruara, i cili do të integrohet me sistemin ekzistues të parkimit, është i pajtueshëm me kërkesat ligjore për faturimin dhe fiskalizimin në Republikën e Shqipërisë.

Zgjidhja e fiskalizimit duhet të jetë e certifikuar nga subjektet e autorizuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Argumentimi: Bazuar në ligjin Vendimin Nr. 239, date 20.03.2020 “Për Kërkesat Teknike dhe Funksionale të Zgjidhjes Softwareike për Proçedurën e Faturimit dhe të Fiskalizimit si dhe Proçedurën e Kriteret për Regjistrimin e Prodhuesve e të Mirëmbajtësve të Zgjidhjeve Software-ike” në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 10, të nenit 16, të ligjit Nr.87/2019, “Për faturën dhe sistemin e monitorimit të qarkullimit...” çdo shërbim financiar ndaj klientëve duhet të shoqërohet me kupon tatimor, dhe për këtë arsye O.E i interesuar duhet të vërtetojë që ka kapacitetin ligjor të kryejë proceset e fiskalizimit të faturave sipas legjislacionit në fuqi.

Kasat automatike të parkimit kryejnë transaksione financiare dhe lëshojnë dokumente tatimore për përdoruesit e shërbimit. Për këtë arsye, software-i që i administron duhet të jetë i integrueshëm me sistemin ekzistues të parkimit dhe njëkohësisht i pajtueshëm me kërkesat e fiskalizimit elektronik, në mënyrë që çdo transaksion të regjistrohet dhe transmetohet sipas legjislacionit tatimor në fuqi.

Kërkesa që zgjidhja e fiskalizimit të jetë e certifikuar nga subjekte të autorizuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve synon të garantojë se zgjidhja e ofruar është e vlefshme, e testuar dhe e miratuar për përdorim në Republikën e Shqipërisë, duke shmangur rrezikun e furnizimit me pajisje ose software që nuk mund të vihen në funksion ose që kërkojnë përshtatje të mëvonshme me kosto shtesë.

Ky kriter është i lidhur drejtpërdrejt me objektin e kontratës, është proporcional me natyrën e prokurimit dhe synon të garantojë funksionimin e ligjshëm, të pandërprerë dhe të integruar të sistemit të parkimit dhe të kasave automatike gjatë gjithë periudhës së përdorimit.

2.3.8 Në mënyrë që të krahasohet pajtueshmëria me specifikimet teknike dhe standardet e kërkuara, operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë katalogët ose fragmentët e katalogëve të

prodhuesit/eve /distributorit/ve për mallin objekt prokurimi. Skeda teknike dhe katalogët ose fragmentët e katalogëve duhet të paraqiten në gjuhën/gjuhët e kërkuara në DST.

Argumentimi: Ky kriter është vendosur bazuar në nenin 77 të ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar dhe VKM-së nr.285/2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (i ndryshuar), neni 40, pika 6, fragmenti b), ku citohet se: “Autoriteti/enti kontraktor mund t’u kërkojë operatorëve ekonomikë të dorëzojnë dëshmi, që tregojnë se ata i plotësojnë kërkesat minimale, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, si: b) fotografitë apo katalogët teknikë; dhe/ose”. Kjo është një kërkesë e domosdoshme për të vërtetuar përputhshmërinë e specifikimeve teknike të mallrave objekt prokurimi me specifikimet teknike të paraqitura nga operatorët ekonomikë ofertues. Ky kriter ka për qëllim të sigurojë transparencën, cilësinë dhe kujdesin ndaj specifikimeve teknike dhe standarteve të kërkuara.

Paraqitja e katalogut ose fragmenteve të katalogëve të prodhuesit/eve jep një informacion të qartë në lidhje me mallrat që do të ofrohen. Ky informacion përfshin të dhëna të detajuara rreth artikujve të kërkuar më sipër dhe në bazë të të cilit, autoriteti kontraktor mund të bëjë një vlerësim më të mirë të ofertave të paraqitura. Kriteret për paraqitjen e fragmenteve të katalogut nënkupton që operatori ekonomik është në gjendje të përmbushë standartet e kërkuara për mallrat dhe siguron që oferta është e pajtueshme me kërkesat e tenderit dhe e përshtatshme për detyrat specifike.

Kriteri i mësipërm lidhur me paraqitjen e skedës teknike dhe katalogëve në gjuhë/gjuhët e kërkuara në DST, është vendosur pasi Oferta dhe gjithë korrespondenca dhe dokumentat lidhur me procedurën do të paraqiten në gjuhën/gjuhët e specifikuar në DST, pra shqip ose anglisht. Dokumentat mbështetëse dhe literatura e printuar që janë pjesë e Ofertës mund të jenë në një gjuhë tjetër me kusht që ato të shoqërohen nga një përkthim zyrtar i fragmenteve përkatëse në gjuhën e specifikuar në DST (shqip ose anglisht).

2.3.9 Në rastin kur produkti i ofertuar nga operatori ekonomik nuk lidhet në mënyrë të drejtpërdrejtë me sistemin aktual të parkimit, Operatori Ekonomik duhet të paraqesë dokumentacion teknik që demonstroi zgjidhjen e integritetit të pajisjes me sistemin ekzistues, nëpërmjet ndërfaqeve të komunikimit të disponueshme (API, Web Service ose metoda të tjera ekuivalente).

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është bazuar në nenin 77, pika 4 të Ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar si dhe nenit 40, pika 8 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” e ndryshuar, ku përcaktohet se Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kriteret e tjera të vecanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës.

Ky kriter është vendosur për të garantuar që pajisjet objekt prokurimi të jenë plotësisht të integrueshme me sistemin ekzistues të menaxhimit të parkimit, pa cenuar funksionalitetin e tij dhe pa krijuar nevojën për zëvendësimin ose modifikime të konsiderueshme të infrastrukturës aktuale. Duke qenë se Autoriteti Kontraktor disponon një sistem ekzistues parkimi, është thelbësore që kasat automatike të ofruara të komunikojnë dhe të shkëmbejnë të dhëna në mënyrë të sigurt dhe të

vazhdueshme me këtë sistem. Në rastet kur produkti i ofruar nuk është i lidhur në mënyrë të drejtpërdrejtë me sistemin aktual, paraqitja e dokumentacionit teknik që demonstroi mënyrën e integritetit përmes API-ve, Web Service-ve ose ndërfaqeve të tjera ekuivalente është e domosdoshme për të provuar realizueshmërinë teknike të zgjidhjes së propozuar.

Ky dokumentacion i mundëson Autoritetit Kontraktor të verifikojë paraprakisht se zgjidhja e ofruar është teknikisht e zbatueshme, garanton shkëmbimin korrekt të të dhënave ndërmjet sistemeve dhe shmang rrezikun e mosfunksionimit, kostove shtesë ose vonesave gjatë fazës së implementimit.

2.3.10 Operatori Ekonomik Ofertues duhet të paraqesë deklaratë konformiteti ose dokumentacion ekuivalent të lëshuar nga prodhuesi i kasave automatike, që vërteton se pajisjet e ofruara janë në përputhje me standardet dhe direktivat evropiane të zbatueshme;

- Direktivën e Tensionit të Ulët Directive 2014/35/EU (Low Voltage Directive).
- Standardin evropian EN 62368-1:2014 për sigurinë e pajisjeve IT
- EN 61000-6-4 (EMC – Emetimet në mjediset industriale)
- EN 61000-6-2 (EMC – Imuniteti në mjediset industriale)
- Produkte me module radio opsionale (RFID 125 kHz dhe Mifare 13.56 MHz):
- EN 301 489-1, EN 301 489-3 (EMC)
- EN 300 330 (Radio)
- EN 50364 (Ekspozimi i njeriut ndaj fushave elektromagnetike)
- Direktivat evropiane: 2014/53/EU (RED), 2011/65/EU (RoHS).

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është bazuar nën 77, pika 4 të Ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar si dhe nën 40, pika 8 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” e ndryshuar, ku përcaktohet se Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kritere të tjera të vecanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës.

Kasa automatike është një produkt i cili ka rëndësi kritike për mbarrëvajtjen e punës në sheshparkim dhe është mjeti me të cilin institucioni do të vjelë dhe ruajë të ardhurat.

Gjithashtu, kjo pajisje do të jetë në kontakt të vazhdueshëm me qytetarët, të cilët do duhet ta përdorin këtë pajisje 24/7 për të kryer pagesat e tarifës së parkimit.

Për këto arsye kasa automatike duhet në mënyrë absolute të ketë standarde evropiane për sigurinë fizike, të qëndrueshme ndaj ekspozimit të përditshëm në ambiente të jashtme, për emetime të rrezeve dhe fushave elektromagnetike të cilat mund të dëmtojnë qytetarët dhe stafin që përdor kasën, etj.

Pajisjet objekt prokurimi janë sisteme elektronike dhe elektromekanike që do të funksionojnë në mënyrë të vazhdueshme në ambiente publike, ndaj është e domosdoshme që ato të plotësojnë kërkesat për sigurinë e përdoruesve, funksionimin e qëndrueshëm dhe ndërveprimin pa interferenca me pajisjet e tjera elektronike. Për këtë arsye, kërkohet që operatori ekonomik të paraqesë deklaratë konformiteti ose dokumentacion ekuivalent të lëshuar nga prodhuesi, i cili provon se pajisjet janë në përputhje me direktivat dhe standardet evropiane të kërkuara.

Në rastin e pajisjeve që përfshijnë module radio (si RFID 125 kHz dhe MIFARE 13.56 MHz), përmbushja e standardeve përkatëse garanton që komunikimi me radiofrekuencë të jetë i sigurt, i besueshëm dhe në përputhje me kërkesat rregullatore, pa krijuar ndërhyrje elektromagnetike apo rreziqe për përdoruesit.

Paraqitja e këtij dokumentacioni i mundëson Autoritetit Kontraktor të verifikojë se pajisjet e ofruara janë produkte të certifikuara, të sigurta dhe të përshtatshme për përdorim, duke minimizuar rrezikun e furnizimit me pajisje që nuk përmbushin standardet ndërkombëtare të cilësisë dhe sigurisë.

Shënim: 1. OE duhet të mbajnë në konsideratë përcaktimet ligjore, referuar Nenit 26, pika 1, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, ku parashikohet se, “Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla”, si dhe përcaktimet e pikës 6, të këtij neni, në lidhje me momentin e paraqitjes së dokumentacionit dëshmuës për kërkesat që përfshihen në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, ku parashikohet që, “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin.”.

- Mosparaqitja e dokumentacionit provues, do të jetë kusht s'kualifikimi.*
- Autoriteti Kontraktor do të bëjë verifikimin e dokumentacionit në përputhje me vetëdeklarimin e bërë gjatë fazës së ofertimit. Konstatimi i mospërputhjeve midis Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit dhe dokumentacionit të dorëzuar përbën kusht s'kualifikimi.*

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.

Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente me të dhëna të rreme ose të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike:

*Termat e referencës/ Specifikimet teknike janë hartuar nga struktura të specializuara/ Grup pune për objektin që prokurohet, i ngritur me Urdhër të Titullarit për hartimin e specifikimeve teknike/ termave të referencave për procedurën me objekt “**Blerje kasa automatike për sistemet e parkimit**”, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 40, pika 1, 2 dhe 3, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, **duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar**, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.*

SHËNIM: Në Specifikimet Teknike, nuk duhet të përkthuhet asnjë markë specifike prodhimi ose burim ose proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një Operator specifik Ekonomik ose ndonjë markë tregtare, patentë, tip ose origjinë ose prodhim specifik, për të favorizuar ose eliminuar ndërmarrje ose produkte të caktuara. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste të jashtëzakonshme kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë ose e kuptueshme për të përshkruar objektin e Kontratës. Referencat e tilla duhet të shoqërohen me fjalët "ose ekuivalent".

Në hartimin e specifikimeve teknike, autoritetet /entet kontraktore mbajnë në konsideratë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin përkatës në fushat, si më poshtë:

a) Kërkesat minimale të performancës së energjisë, siç përcaktohet në legjislacionin në fuqi për efikasitetin e energjisë dhe për performancën energjetike në ndërtesa, konsumin e energjisë dhe burimeve të tjera të produkteve me ndikim në energji, përfshirë parashikimet për përdorimin e etiketave për produktet me ndikim në energji;

b) Specifikimet teknike për produkte të caktuara, siç përcaktohet në aktet ligjore dhe nënligjore të fushës me qëllim përmirësimin e performancës energjetike dhe uljen e ndikimit në mjedis;

c) Çdo parashikim tjetër që buron nga legjislacioni mjedisor, energjetik, social dhe i punës.

Shënim: Në kuptim të nenit 36 të Ligjit nr. 162 datë 23.12.2020, i ndryshuar, pika 3/b, specifikimet teknike duhet të përshkruajnë qartë kërkesat e autoritetit kontraktor, duke iu referuar standardeve kombëtare, që mbështeten në ato ndërkombëtare, miratimeve teknike ndërkombëtare, specifikimeve teknike të përgjithshme, standardeve ndërkombëtare apo sistemeve të tjera teknike të referimit, të përcaktuara nga organet ndërkombëtare të standardizimit. Kur këto nuk ekzistojnë, ato u referohen standardeve kombëtare, miratimeve teknike kombëtare ose specifikimeve teknike kombëtare, që lidhen me projektimin, përlllogaritjen dhe ekzekutimin e punëve apo përdorimin e produkteve.

Argumentimi, sipas materialit të përgatitur nga struktura e posaçme:

*Në mbështetje të nenit 8, pika 2, nenit 9, pika 1/1.1, shkronja "d", dhe nenit 64, shkronja "a" të Ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015 për "Vetëqeverisjen Vendore" (i ndryshuar); Ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 për "Menaxhimin financiar dhe kontrollin" (i ndryshuar); nenit 36 të ligjit nr. 162/2020, datë 23.12.2020 "Për Prokurimin Publik" (i ndryshuar); nenit 76 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 për "Miratimin e rregullave të prokurimit publik" (i ndryshuar); grupi i punës hartoi specifikimet teknike për realizimin e objektit: **"Blerje kasa automatike për sistemet e parkimit"**, duke përcaktuar qartë kërkesat e Autoritetit Kontraktor.*

Bazuar në specifikimet teknike të miratuara dhe hartuara nga struktura e ngarkuar për këtë qëllim, Grupi i punës vendosi të bëjë studimin e tregut për çmimin e pasjisjeve, mbi bazën e të cilës përcaktohet fondi limit për procedurën e prokurimit. Pas identifikimit të subjekteve që operojnë në fushën e aktivitetit të objektit që prokurohet, kërkesa për përlllogaritjen e fondit limit me qëllim llogaritjen e vlerës së kontratës, ju dërgua 3 subjekteve, në përputhje me kërkesat teknike të përgatitura nga komisioni i ngritur me Urdhër të Titullarit të Autoritetit Kontraktor.

Grupi i punës i përbërë nga specialistë të fushës, i ngritur urdhër të Titullarit të AK, Bashkia Tiranë, në zbatim të detyrave të përcaktuara në këtë urdhër, pas identifikimit të nevojave për materialet objekt prokurimi, në funksion të zhvillimit të detyrave të punonjësve të administratës, përgatiti specifikimet teknike dhe relacionin prezantues për realizimin e furnizimit me këto materiale.

Njësia e Prokurimit: